



## AKTI I THEMELIMIT

Sot, me 10.1.1995 ( nëntëdhjetë e pesë ) unë themeluesi i shoqërisë private me përgjegjësi të kufizuar " ANLREA TOTO i biri i Millos, me dt.1967 , lindur dhe banues ne Fushë Krujë , me nr?pässeporte NF 305377 , themeloj shoqërine private te quajtur " TOTO " sbpk .

### NENI 1

Shoqëria emërohet " TOTO " sbpk dhe ushtron veprimtarine e saj me ortakun e vetem themelues .

### NENI 2

Shoqëria është person juridik dhe ne bazë të ligjit 7638 dt. 19.11.1992 e fiton zotësinë për të vepruar nga momenti i rregjistrimit të saj ne gjykatën e rrethit Tiranë !

### NENI 3

Selia e shoqërisë do të jetë ne Fushë Krujë .

Ajo ka të drejtë që të çelë dargë apo agjenci të reja ne rrethe të tjera te Shqipërise .

### NENI 4

Shoqëria do të ketë kohe zgjatje te pakufizuar .Ajo mund te priset ne çdo kohe ne baze te ligjit ,kur jane kushtet e prethanat ose ne vendim te ortakut të vetem themelues .

### NENI 5

Objekti i shoqërisë do të jetë : Ushtrimi i veprimtarisë private ne fushën e prodhimit blloqe betoni , prerje guri mermeri , e tregtimi i tyre eksport-import, me shumicë e pakicë

Objekti mund të shtohet ose pakësohet sipas mundësive që i krijohen stij .

NENI 6

Si administrator të saj shoqëria do të emërojë ortakun e vetëm themelues ANDREA TOTO , i cili ka të drejtë që të ushtroje çdo lloj veprimtarie ne emrin dhe për llogaritë e shoqërisë .

Ai mund të caktojë si administrator dhe një person tjetër me kontratë pune .

NENI 7

Kapitali i shoqërisë përbëhet prej 100.000 lekë të depozitues në Bankën e zgjedhur prej vete ortakut themelues .

Ai mund të shtohet ose pakësohet sipas mundësi të krijues prej vete ortakut themelues.

NENI 8

Fitimet e realizuara prej shoqërisë do të kalojnë në favor të ortakut të vetëm themelues pasi të shlyhen të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ushtrimi i veprimtarisë .

NENI 9

Shoqëria mund të ushtroje veprimtarinë e saj duke u bashkuar edhe me ortak tjetër po të jete e nevojëshme duke plotësuar kërkesat e ligjit ne fuqi .

NENI 10

Pasi lexohet akti i themelimit firmoset rregullisht prej ortakut të vetëm themelues .

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
NOTERIA -TIRANE



ORTAKU TËMËR LUES  
( ANDREA TOTO )

Nr. 176 rep  
Nr. 70 kol

Sot, me 10.1.1995 ( nëntëdhjetë e pesë në zyrën e noterisë Tiranë, u përqit personalisht ANDREA TOTO ,madhor, me zotësi te plote per te vepruar, i cili deklaroi se akti i themelimit është sipas vullnetit të lirë dhe të pavarur, si firmos rregullisht dhe une noterja e vërtetoj sipas ligjit .



NOTERE  
( VIOLETA LEBRAJ )

# STATUTI

## I SHOQËRISË ME PËRGJEGJSI TË KUFIZUAR

### "TOTO" shpk

Sot, me 10.1.1995 ( nëntëdhjetë e pesë ) në zyrën e avokatisë Tiranë, në bazë të aktit të themelimit të përpiluar prej meje është krijuar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "TOTO" shpk. Bashkëlidhur tij përpiloj këtë statut si më poshtë vijon :

#### ENI 1

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "TOTO" shpk e ushtron veprimtarinë private me ortakun e vetëm themelues Andrea Toto .

#### ENI 2

Selia e shoqërisë do të jetë në Fushë Krujë .Ajo ka të drejtë që të çelë degët apo agjenci të reja në rrethet apo qytete të tjera sipas mundësive që atij i krijohen .

#### ENI 3

Objekti i shoqërisë është : Ushtrimi i veprimtarisë private në fushën e prodhimit të blloqeve prej betoni , prerje guri e mermeri dhe tregtimi i tyre me shumicë e pakicë, eksport-import .

Shoqëria ka të drejtë që të shtojë ose pakësojë objektin e saj sipas mundësive që i krijohen .

#### ENI 4

Si administrator i shoqërisë do të caktohet ortakun i vetëm themelues ANDREA TOTO, i cili ka të drejtë dhe kompetencë të plotë që të kryej çdo lloj veprimtarie në emrin dhe për llogari të shoqërisë.

#### ENI 5

Kapitulli i shoqërisë përbëhet prej 100.000 lekë , që përfshihen në xhiro të depozituara në Bankën e zgjedhur prej vete ortakut themelues .

Ai mund të shtohet ose pakësohet me vendim të ortakut të vetem lues .

Ai është lirisht i transferueshem dhe mund të libet peng me akt noterial .

#### NENI 6

Fondet e shoqërusë pë cëktohet nga ortaku themelues dhe përbëhet prej :

1. Fondi themelor

2. Fondi rezerve

3. Fonde te tjere ,te cilat mund të jane te nevojëshme për realizimin e veprimtarisë se saj .

Masa e secilit fond do te pëktohet me vendim të ortakut të vetem themelues .

#### NENI 7

Administratori kryhen veprime ,të cilat jane te detyrueshme për shoqërine . Shoqëria përgjigjet për çdo detyrim që lind gjate veprimtarisë ajo nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve ,kur këta të fundit dinin se akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund të injoronin këtë akt ne rrethetat e dhena .

#### NENI 8

Shoqëria ka kohëzgjatje me afat te pëcaktuar ,prëj 12 vjetësh . Ajo mund të prishet me vendim të ortakut të vetem themelues ose kur jane kushtet e parashikuara ne ligj .

#### NENI 9

Eksperti kontsbël kontroillon aktivitetin financiar te shoqërisë i cili miratohet nga ortaku i vetem themelues ,që ne bazë të ligjit kryhen vetem te gjitha veprimet e nevojësme për të realizu r qëllimin e fitimit . Ai ka për detyrë që të kontrolloje aktivitetin financiar arkën , rregjistrin e veprimeve kontsbël .

#### NENI 10

Shoqëria përfëqsohet me firmen e lirë të ortakëve të vetem ai mund të delegeje kompetencat e tij edhe te person tjetër me autorizim ose prokurë .

#### NENI 11

Pas përbëllimit të detyrimeve , tatimeve , taksave

penzimeve te ndryshme si dhe te pag ve te punonës ve që mund të jen  
punësuar ortakë i vetem themelues kalon ne procesine e tij fitimin neto.  
Fitimi neto ndahet :

1. Ne pjesën për zgjerimin e kapitalit
2. Ne pjesën e fitimit .

#### NEANI 12

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar ka të drejtë që të  
punëtojë persona fizik , specialiste për të kryer veprimtarinë e saj  
dhe çdo lloj profesioni duke përpiluar kontrata pune sipas ligjit ne  
fuqi .

#### NEANI 13

Aktivitetin e saj shoqëria do ta ushtrroje kundrejt çmimeve  
sipas ofertës dhe kërkesës me përjashtim të rasteve kur çmimet janë të  
caktuara me vendim te Qeverisë .

#### NEANI 14

Shoqëria mbaron për këtë afati , te caktuar ne afatin e  
caktuar kur janë kushtet e parashikuara ne ligjin nr. 7638 dt.19.11.1992

#### NEANI 15

Pecuria e shoqërisë mund të sigurohet ne institutin e sigurimeve  
neve .Viti financiar i shoqërisë fillon çdo llin viti kalendërik me  
përjashtim të fillimit të aktivitetit të saj .

#### NEANI 16

Likuidimi i shoqërisë rregullisht bëhet nëpërmjet dispozitave  
ve që përmbahen ne statut duke mbajtur parasysh dhe dispozitat e nenit  
264 te ligjit 7638 dt.19.11.1992 .Shoqëria është ne likuidim e sipër  
që ne momentin e prishjes së saj për çfarëdo lloj arsye me përjashtim të  
restit te parashikuar ne nenin 10 te ligjit 7638 dt. 19.11.1992 .

Që prej këtij momenti qahet shoqëri ne likuidim e sipër  
dhe përcaktohet nga shenimi " Shoqëri ne likuidim e sipër " .



Statuti firmoset rregullisht dhe ortaku i vetë  
themelues ka të drejte që të shtojë ose përkusojë nënë sipas  
mundësive që atij i krijohen .

ORTAKU I VETË  
( ANDREA TOTO " TOTO " shpk

REPUBLIKA E SHQIPARISË  
NOTERIA - TIRANË  
NR. 177 REP  
NR. 70 KOL

V E R T E T I M

Set, me 10.1.1995 ( nëntëdhjetë e pesë ) në zyrën e  
noterisë në zyrën e noterisë Tiranë, u paraqit personalisht :  
ANDREA TOTO " TOTO " shpk , meqë, me zotësi të plotë për të  
vepruar , i cili deklaroi se statuti është sipas vullnetit të  
lirë dhe të paverir ai firmos rregullisht dhe me noterje e  
vërtetohet sipas ligjit .

NOTERE  
( VIOLINA LEMAJ )

